

Data 29.03.2023

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROKURIMIT:

“Ngritja e Qendres Rinore Inovative Puke”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): **Punime Ndertimi 45210000-2**

VLERA E FONDIT LIMIT:

2,831,448 (Dymilion e teteqinde e tridhjetë e njëmijë e katerqinde e dyzet e tete) leke pa tvsh

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Puke ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës ...;*
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas Shtojcës*
- c. Formulari i ofertes ,sipas shtojcës 1*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020-2021-2022, ku vlera e xhiros për

të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit.

Argumentimi: K Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Neni 55 pika 4 paragrafi II

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar eshte bere ne mbeshtetje te nenin 43, pika 1 ” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku percaktohet se: ” Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare”.

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2020, 2021, 2022, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, pika ”c”, të ligjit nr.10091 datë 5.3.2009 ”Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjin nr. 25/2018 ”Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe neni 41, pika ”c”, e ligjit nr.10091 datë 5.3.2009 ”Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 30 % e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se vlera limit e kontratës që prokurohet.

- Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme
- Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, situacionin përfundimtar të punimeve si dhe fatura tatimore.
- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.
- *Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 30 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo më e vogël se vlera limit e kontratës, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” në nenin 55, pika 4

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministri e Infrastrukturës dhe Energjisë bazuar në formatin e Vkm nr 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

1. N.P – 3 A Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile dhe industriale,veshje fasada

Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Institucionit përkatës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendim të Keshillit të Ministrave Nr. 42 date 16.01.2008, ”Per miratimin e rregullores per kriteret dhe Procedurat e dhenies se licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te Subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi, gjithashtu Te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 8 përcakton "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane. Kategoritë e mesiperme janë kërkuar bazuar në zërat dhe volumet e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjisllacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
N.P – 3 A	Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile dhe industriale,veshje fasada		A	0 – 20 mln

2.3.3 Një punësim mesatar i të paktën 14 (katermbedhjetë) personave, të cilët duhet të jenë pjesë e listëpagesave të muajit Dhjetor 2022-Shkurt 2023;

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor I kërkon ofertuesit të kualifikuar, I pari dorëzimin e dokumenteve provuese si dhe

dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Argumentim: Autoriteti Kontraktor këtë kriter e ka bazuar në nenin 77, pika 4 të Ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” në të cilin thuhet: “Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”.

Numri i punonjësve është përcaktuar bazuar në grafikun e punime, në afatin, orët e punës dhe pagën minimale të lejuar, që duhen për të përmbushur zbatimin e kontratës. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështirje Dhjetor 2022-Shkurt 2023, tregon besueshmëri për autoritetin. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, përpiket të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosja e kriterit për njëpunësim të paktën 14 (katërmbëdhjetë) persona duke përfshirë dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën dhe terrenin ku do të kryhen punimet. Po t’i referohemi projektit, preventivit, relacionit, matjeve përkatëse që ka bërë projektuesi është plotësisht i justifikuar numri i punonjësve. Kriteri për kualifikim është vendosur që t’i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Analizat teknike janë bazuar në VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “ Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018). Bazuar në kriter elementet e struktura të kostos (material, puntori, makineri, transport) zeri fuqi punëtore ze rreth 20% të kostos.

2.3.4 Operatori/et ekonomike për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, duhet të vërtetojë se ka **ne licencën e shoqërisë** si drejtues teknik për kryerjen e punimeve në këtë objekt,

Inxhinier Ndërtimi

1 (nje)

Për stafin e mësipërm të paraqiten:

- Kontratë individuale të punës
- Diploma/certifikata,

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë punonjësit që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor I kërkon ofertuesit të kualifikuar, I pari dorëzimin e dokumenteve provuese si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike . Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njësuara me origjinalin

Argumentim: Autoriteti Kontraktor këtë kriter e ka bazuar në nenin 77, pika 4 të Ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” në të cilin thuhet: “Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”.1 Inxhinier ndertimi eshte i nevojshem ne cdo procedure ndertimi

Numri i punonjësve është përcaktuar bazuar në afatin, orët e punës dhe pagën minimale të lejuar, që duhen për të përmbushur zbatimin e kontratës. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje Dhjetor 2022-Shkurt 2023, tregon besueshmëri për autoritetin. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Kriteri për kualifikim është vendosur që t’i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Analizat teknike janë bazuar ne VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “ Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018). Bazuar ne kater elementet e struktures se kosos(material, puntori, makineri, transport) zeri fuqi puntore ze rreth 20% te kosos.

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr.	Emertimi	Njesia	Sasia
1	Kaminon transporti 10 ton	cope	2
2	Kamioncine	cope	1
3	Vinç kulle deri 5 ton	cope	1
4	Elektro argano	cope	1
5	Trapomo	cope	1

6	Betoniere 500 liter	cope	1
7	Pompe suvatimi	cope	2
8	Skele inventari	m2	116
9	Zmerilatrice	cope	1

a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (te vlefshme), taksen vjetore dhe për mjetet e siguruar me qera, dokumenti që verteton regjistrimin e tij plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit,(te vlefshme) duhet të shoqërohet me kontratën perkatese të qerave, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jepen aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.

b) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.

c) Për mjetet e marra me qera të të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.

d) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor I kërkon ofertuesit të kualifikuar, I pari dorëzimin e dokumenteve provuese si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike . Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njësuara me origjinalin

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e mjeteve/makinerve të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës *bazuar ne VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018).*

2.3. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i Çertifikuar sipas standarteve ISO të leshuara nga organizmat e vleresimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat nderkombetare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, ose ekuivalente konkretisht:

- a) Certifikate ISO 9001:2015 Sistemet e menaxhimit te cilesise/ **ekuivalente dhe e vlefshme**
- b) Certifikate ISO 14001:2015 Sistemet e menaxhimit te ambientit / **ekuivalente dhe e vlefshme**
- c) Certifikate ISO 45001-2018 (Sistemi i Menaxhimit dhe Sigurise ne Pune)/ **ekuivalente dhe e vlefshme**
 - *Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave te punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes).*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 44, pika 1 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

2.3.7Grafik punimesh.

Preventivi, përcaktimi i numrit të punonjësve, makinerite dhe numrit të tyre, si dhe afati i kryerjes së punimeve janë pjesë e projekt-zbatimit, të cilat janë hartuar konform analizave teknike bazuar ne VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018). Duke ju referuar këtij vendimi dhe duke analizuar strukturën e kostos “punëtori” dhe “makineri” që nevojiten për realizimin e punimeve në volume sipas parashikimit të preventivit 2818 ore pune.

Emërtimi i llojit të makinerive në tabelën e mësipërme është identike me emërtimin që kanë ato në analizën teknike për zërin e punës ku është gjetur ajo në manual, kurse sasia e makinerive është përcaktuar jo vetëm nga volume i orëve të punës, por edhe nga llogjika e realizimit në kohë për zëra të veçanta, më shpejt se 4 javë të parashikuara ne grafik.